



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:291007

Datë: 27.12.2023

Numri i dokumentit: 05129415

P.nr.1157/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska, në çështjen penale kundër të pandehurit V. M. nga Peja, me vendbanim në rrugën " A. J.", nr. 16 Peje dhe fsh. B. K-Peje, për shkak të veprës penale "Vjedhja" nga neni 313 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1884/23 të datës 21.12.2023 dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë seancës, me datë 27.12.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1884/23 të datës 21.12.2023 andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPPRK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

V. M., i lindur me datënë Pejë, me vendbanim në rrugën " A. J." nr.16 dhe ne fsh. B. K-Peje, nga i ati A. dhe nëna A., e vajzërisë Berisha, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër, i nacionalitetit shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datë 21.09.2023 rreth orës 20:00, në Rr. "B. B. – A." në Pejë, afër markës "I.", me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej më pak se pesëdhjetë (50) Euro, dhe atë të dëmtuarit N. K. në atë mënyrë që, gjersa i dëmtuari ishte duke shitur perime në skaj të rrugës, aty i ofrohet i pandehuri dhe i thotë se do i blejë të gjitha perimet dhe i njëjti i thotë se i ka vetëm pesëqind (500) franga zvicerane ndërsa duhet të paguaj një borxh ku kërkon nga i dëmtuari shumën prej tridhjetë (30) Euro, dhe posa i dëmtuari ja ia jep ato, i pandehuri me vrap largohet nga vendi i ngjarjes duke përvetësuar paratë,

- Me çka ka kryer veprën penale "**Vjedhja**" nga neni 313 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 38, 39, 40, 43,61, dhe 69 të KPRK-ës, si dhe bazuar në nenet 365, 493, 495 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- Në lartësi prej 100 € (njëqind) Euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë në afat prej 3 muajsh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.
- Në rast se i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë, gjykata do ta zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.
- Urdhërohet i dënuari V. M. që në emër të shpërblimit të dëmit t'i paguajë të dëmtuarit N. K. shumën në lartësi prej 30 € (tridhjetë), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.
- OBLIGOHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 € (njëzet) euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 € (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së

marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1884/23 të datës 21.12.2023, kundër të pandehurit V. M., për shkak të veprës penale “Vjedhja” nga neni 313 par.2 të KPRK-së.

Së bashku me aktakuzën prokuroria ka dorëzuar kërkesën me të cilën ka kërkuar që të pandehurit V. M., t’i shqiptohet urdhri ndëshkimor- dënim me gjobë.

I pandehuri është i akuzuar për veprën penale “Vjedhja” nga neni 313 par.2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074), që e ka këtë përshkrim: “Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjete (50) euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vetë apo për personin tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. Nëse vlera e pasurisë së vjedhur është më pak se pesëdhjetë (50) euro, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj”.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 dhe 495 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, ashtu që vendosi ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Raporti i zyrtarit policore H. Z. *..., i datës 22.09.2023, Raporti elektronik i zyrtarit policore Xh. Sh.*... i datës 23.09.2023, Procesverbali i marrjes në pyetje nga policia të dëmtuarin N. K. i datës 21.09.2023, Procesverbali i marrjes në pyetje nga policia të pandehurin V. M. i datës 23.09.2023, janë prova që ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe se i pandehuri ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074).

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, gjykata u mbështet në nenin 43 par.1 dhe 2, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074), ku nga provat e bashkangjitura lëndës dhe faktet e përshkruara si në aktakuzë gjykata erdhi në përfundim se dënimi me gjobë i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrijë qëllimin e dënimit siç parashihet në nenin 38 të KPPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të

ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Kur u vendos në lidhje me dënimin plotësueses, urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit, më të cilën u urdhërua i pandehuri V. M., që të dëmtuarit N. K. t'i kompensoj dëmin në lartësi prej 30 € (tridhjetë), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim, gjykata u mbështet në nenin 61 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga se u tha më lartë, në kuptim të neneve 364 dhe 495 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal

P.nr.1157/23, me datë 27.12.2023

Procesmbajtësja:
Shpresa Kërnja

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.

Vërejtje:

Nëse nuk paraqitet kundërshtimi brenda afatit të lartshënuar, urdhri ndëshkimor merr formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar të pandehurit ekzekutohet.